

THIRRJE

PËR LEGJISLATORËT SHQIPTARË QË KANË NË DORË ZANAFILLËN E REFORMËS NË DREJTËSI

Tiranë, 7 janar, 2016. Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) i bën thirrje parlamentarëve shqiptarë dhe partive politike të marrin parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias, thirrjet e ndërkombëtarëve, të shoqërisë civile dhe pritshmërinë e shqiptarëve në lidhje me urgjencën e miratimit të ligjit për Reformën në Drejtësi.

Reforma në Drejtësi përbën prioritet absolut për Shqipërinë.

Si legjislatorë ju mbani në dorë fatin e ndryshimeve pozitive për Shqipërinë në shumë aspekte, por reforma në drejtësi është e një rëndësie të veçantë dhe do të shënojë pikën e kthesës për fatin e shqiptarëve. Ky është moment për të treguar përgjegjshmëri dhe urtësi për të cilën kanë aq shumë nevojë qytetarët që ju kanë zgjedhur. KZLNDQ ju bën thirrje të përdorni kohën në dispozicion në mënyrë racionale që kjo reformë të fillojë të zbatohet brenda muajve të parë të këtij viti.

Reforma në Drejtësi garanton mirëqeverisje dhe luftë kundër korrupsionit në një sistem demokratik. Me ligjin për Reformën në Drejtësi të miratuar një orë e më pare ju i jepni shpresë shqiptarëve se korrupsioni do të luftohet, se çdo individ apo grup i përfshirë në krim do të marrë përgjigjen e merituar dhe se ne shqiptarët zotërojmë maturinë e nevojshme që na rrit shancet për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Zonja e zotërinj parlamentarë, ju lutem merrni parasysh çdo rekomandim të Komisionit të Venecias dhe kontributet e shoqërisë civile për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një koalicioni pavarur, jopartiak, i krijuar me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në votime dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. KZLNDQ i kushton vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut përpara ligjit, çështjeve që ndikojnë tek votuesit me aftësi të kufizuara si dhe çështjeve të barazisë gjinore. KZLNDQ përbëhet nga 30 organizata partnere dhe nga qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë të cilët japin kontributin e tyre në përpjekjet dhe aksionet e KZLNDQ-së. Për më shumë informacion ju lutem vizitoni www.kzln.org.al dhe/ose kontaktoni me by e-mail: kzln@kzln.org.al.

